

### **KONTRATA**

Me datë 14-12-2018 në mes të:

**KOMUNA E PRISHTINËS**, rruga: UÇK 2, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë dhe

Dhe "N.Sh."L-CONSULTING" nga Klina-Zllakuqan, me numër të regjistrimit të biznesit 71015947 dhe me numër fiskal 601052020 përfaqësuar nga Luigj Markaj – Drejtore në tekstin e mëtejme ("Kontraktuesi"), janë pajtuar si në vijim:

#### **Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban**

**Numri i Prokurimit : 616 18 144 236**

#### **Neni 1 Lënda**

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë "Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban"
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të kontratës
- 1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së urdhëresës.
- 1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Prishtine
- 1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

#### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk

---

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### **Neni 3           Çmimi**

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: 8300,00 €; [tetë mijë e treqind Euro ]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

### **Neni 4           Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

### **Neni 5   Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

### **Neni 6           Kualiteti**

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

### **Neni 7   Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të shërbimeve

### **Neni 8           Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë,

Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### **Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### **Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**



13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

**Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqip në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	Zekë Bardhaj <i>Nezhati Mekeci</i>	Emri:	<i>Tush Meroj</i>
Pozita:	Udhëheqës i Prokurimit	Pozita:	<i>prokt. mençies dhe apert</i>
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>	Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	<i>14-12-2018</i>	Data:	<i>14.12.2018</i>
Vula:		Vula:	

## **PJESA C: FORMULARI I PARAOITJES SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT**

### **Seksioni I. Formulari i KUOTIMIT TË ÇMIMIT**

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES (më tej “Autoriteti Kontraktues”)

Titulli i Kontratës: Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban

Në përgjigje të letrës suaj të ftesës për tender për kontratën e mësipërme, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Ne kemi shqyrtuar dhe pranuar përmbajtjen e plotë të dosjes së tenderit Nr 616-18-8986-2-3-6. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësinë e tyre, pa rezervim ose kufizim.

2. Çmimi i përgjithshëm i kuotimit është:

Çmimi i përgjithshëm i kuotimit në shifra: [shëno çmimin e përgjithshëm në shifra €] 5'300.000

Dhe me shkrim [shëno çmimin e tenderit me shkrim Euro] tet mij e deri mij e 300 mij €



3. Ky kuotim është i vlefshëm për një periudhë prej 30 ditëve nga data përfundimtare për dorëzimin e kuotimit të çmimeve.

4. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Ne gjithashtu plotësisht të njohim dhe pranojmë se ndonjë informacion të pasaktë ose të paplotë të dhënë me qëllim në këtë aplikacion mund të rezultojë në përjashtimin tonë nga kjo dhe kontrata të tjera të financuara nga BKK.

5. Çmimi i përgjithshëm i kuotuar është fiks dhe nuk i nënshtrohet ndonjë ndryshimi gjatë kontratës (duke përjashtuar çmimet e këtyre artikujve që janë subjekt i rregullimeve të çmimeve në bazë të shkëmbimit të aksioneve përkatëse). Çmimi i përgjithshëm i kuotuar specifikohet dhe është i bashkangjitur në Specifikimet e Çmimit.

### **DORËZUAR NGA:**

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	NSH “L-Consulting”
ADRESA E PLOTE	Zllakuqan, Klinë, pa nr.
PERFAQESUAR NGA:	<u>Lvig Markaj</u>

EMRI	Luigj Markaj
POZITA	Drejtor
NENSHKRIMI	
DATA	17.11.2018
VULA	

## Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Paramasa dhe paralogaria të shkarkohet nga Platforma elektronike

PËRSHKRIMIT I ÇMIMIT PËR VSM-në					
Pozicioni	Përshkrimi i Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi i pozicioni
1	Faza përgaditore e Raportit dhe angazhimi i ekspertëve	Copë	1	1000	1000
2	Përgaditja e draft raportit të VSM	Copë	1	6000	6000
3	Përgaditja e Prezentimit për Debat Publik	Copë	1	1000	1000
4	Përgaditja dhe dorëzimi final i Raportit të VSM	Copë	1	700	700
TOTALI					9700



Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

**DETYRA PROJEKTUESE PËR HARTIMIN E Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) të Prishtinës 2018-2028**

**1. Qëllimi i hartimit të të Prishtinës**

*LIGJI Nr. 03/L-230 Per Vlersimin Strtegjik Mjedisor përcakton kushtet, mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, të planeve dhe programeve të caktuara, përmes integritit të parimeve të mbrojtjes së mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve, me synim të promovimit të zhvillimit*

*Qëllimi i këtij ligji është që me vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.*

**2. Hartimi i VSM për Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU) të Prishtinës ka për qëllim:**

VSM për planet dhe programet bëhet atëherë kur ekziston mundësia që realizimi i tyre të shkaktojë dëme të konsiderueshme në mjedis.

Hartimi i raportit për VSM është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësinor dhe urbanistik, në shfrytëzimin e tokës, bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë, energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, menaxhimit e mbeturinave, menaxhimit e ujërave, telekomunikacionit, turizmit, të cilat japin kornizën për zhvillimin e ardhshëm të projekteve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis në përputhje me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis si dhe për planet dhe programet të cilat, duke marrë parasysh lokacionin në të cilin realizohen, mund të ndikojnë në zonat e mbrojtura, në habitatet natyrore dhe në florën e faunën e egër.



### 3. Përmbajtja e VSM për PMQU

sipas Ligjit të VSM raporti i VSM duhet të përmbajë:

1. Një përshkrim i përmbajtjeve, objektivave kryesore të planit ose programit dhe marrëdhënieve me plane ose programe të tjera;
2. Aspektet përkatëse të gjendjes aktuale të mjedisit zhvillimi i ngjashëm për zbatimin e planit ose programit;
3. Karakteristikat mjedisore të zonave që mund të preken konsiderueshëm;
4. Problemet ekzistuese mjedisore që lidhen me planin ose programin, duke përfshirë në veçanti problemet që lidhen me zona të një rëndësie të veçantë mjedisore, si për shembull zonat e projektuara sipas Direktivave 79/409/EEC dhe 92/43/EEC;
5. Efektet më të rëndësishme të mundshme mbi mjedis, duke përfshirë dhe çështje të tjera si biodiversiteti, popullsia, shëndeti i njerëzve, fauna, flora, toka, uji, ajri, faktorët klimaterikë, asetet materiale, trashëgimia kulturore duke përfshirë trashëgiminë arkitekturore dhe arkeologjike, pamjen dhe ndërlidhjen ndërmjet faktorëve të mësipërm;
6. Masat e parashikuara për të shmangur, ulur dhe për të zhdukur sa më shumë të jetë e mundur efektet domethënëse negative mbi mjedis gjatë zbatimit të planit ose programit;
7. Një përshkrim të arsyeve për përzgjedhjen e alternativave të trajtuara, dhe një përshkrim të mënyrës se si u realizua vlerësimi, duke përfshirë vështirësitë (si për shembull mangësitë teknike ose mungesa e njohurive teknike) të hasura gjatë përgatitjes së informacionit të kërkuar;
8. Një përshkrim të masave të parashikuara për monitorimin, sipas ligji për VSM
9. Një përmbledhje jo teknike të informacionit të dhënë nën kategoritë e mësipërme dhe detyrat tjera që dalin nga legjislacioni në fuqi.

#### **4. Procesi i hartimit të VSM, monitorimi, vlerësimi dhe miratimi**

Procesi i hartimit të VSM do të udhëhiqet konform dispozitave të *Ligjit të VSM*

Përmbajtja e Programit të VSM, procesi i hartimit të Planit dhe përmbajtja e Planit do të monitorohet dhe do të vlerësohet nga Komisioni për monitorim dhe vlerësim të VSM, të përcaktuar nga Komuna

Përveç takimeve formale të punës me autoritetet e planifikimit të Komunës së Prishtinës, hartuesi i Planit do të mbajë konsultime të vazhdueshme me menaxherin e projektit dhe , do të përvetësojë rekomandimet për procesin dhe përmbajtjen e raportit të VSM me qëllim të marrjes së Masave të parashikuara për të shmangur, ulur dhe për të zhdukur sa më shumë të jetë e mundur efektet domethënëse negative mbi mjedis gjatë zbatimit të planit ose programit.

Kompania e angazhuar për përgatitjen e VSM-së do të hartojë dinamikën e integruar të punës në Plan dhe diagramin e mbarëvajtjes së procesit të Planit, në harmoni me Udhëzimin Administrativ Nr. rendor 54/2005, Nr. protokollit 15/05 dhe me obligimet në bazë të kushteve të veqanta dhe të përgjithshme të përcaktuara me kontratë.

#### **5. Dorëzimi i Planit**

Raporti i VSM duhet të dorëzohet në:

- pesë (5) kopje të shtypura në lidhje të fortë (palosja në formatin A4);
- në formë elektrike – CD

#### **6. Kompetencat e individit në kompaninë konkurse**

Profesionalizmi: tregon kompetencë profesionale dhe zotërim të lëndës. Hulumtim të mirë, analitike dhe aftësi në problem-zgjidhjen. Ndërgjegjshëm dhe efikas në përmbushjen e angazhimeve, duke respektuar afatet dhe arritjen e rezultateve.

Komunikimi: Aftësi të shkëlqyera dhe efektive me shkrim dhe me gojë, aftësinë për të bindur njerëzit me pika të ndryshme dhe për të paraqitur informacionin në një mënyrë koncize dhe të saktë

Planifikimi dhe Organizimi: aftësinë e provuar për të planifikuar, koordinojë dhe monitorojë punën. Aftësia për të punuar nën presion dhe e përdor kohën në mënyrë efikase. Identifikon aktivitetet prioritare dhe detyra. Punon në bashkëpunim me kolegët për të arritur qëllimet organizative. Kërkon të dhëna nga të tjerët vlerësimin e ideve dhe ekspertizës dhe është i gatshëm për të mësuar nga të tjerët.

### **Detyrat kryesore**

Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të përgjegjëseve të komunës kompania do të përmbushë këto detyra:

1. Analizojë dhe të shqyrtojë projektin – për aktivitetet/projektet e propozuara në PMQU me pamje kritike për vlerësimin e ndikimit të mundshëm të tij në mjedis në përputhje me ligjet në fuqi.
2. Të marrë pjesë në takimet me ekipin komunes, dhe të konsultohet me palët e interesuara përfshirë ministrinë
3. Të përgatisë dhe mbroj VSM duke u përgjigjur në komente të ndryshme nga grupet apo individët e interesuar
4. Shkruan komentet dhe përkrah finalizimin e raportit mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor
5. Zhvillon Konsulta dhe diskutime me profesionistë të fushës (lokale, qeveria qendrore dhe OJQ-ve) për çështje të dala nga shqyrtimi i ndikimeve të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban në Mjedis / çështjet sociale / ekonomike.
6. Bënë rishikimin dhe finalizimin e raportit të VSM për PMQU, në mënyrë që të aprovohet nga MMPH-ja.

### **Kualifikimet e stafit**

1. Diplomë universitare në studimet e mbrojtjes së Mjedisit ose studime post diplomike në Mbrojtje të mjedisit, përvojë mbi 10 vjeçare profesionale praktike në fushën përkatëse të mbrojtjes së mjedisit.
2. Njohuri praktike në legjislacionin për VSM, VNM dhe ligjin e Mjedisit.
3. Kuptim të mirë të përvojës ndërkombëtare dhe praktikat më të mira në vlerësimin e ndikimit në mjedis.
4. Të ketë referenca në projektet e financuara nga EU në përpilimin e VSM dhe VNM
5. Të ketë së paku një ekspert ndërkombëtarë që ka bërë vlerësime të VSM dhe VNM në Kosovë.
6. Aftësi për të punuar në ekip dhe që merr përsipër iniciativën për të siguruar marrëdhënie të qetë dhe komunikim të hapur brenda ekipit dhe me partnerët
7. Të ketë përvojë në përpilim të VSM dhe VNM.
8. Është thelbësore që kompania të jetë në gjendje të përmbushë afatet për raportimin dhe të gjithë punën e projektit.

Shtojcë e ketyre detyrave bashkangjesim detyrat projektuese për hartimin e PMQU-së.

Për informata shtesë mund të drejtoheni në Drejtorinë e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Adresa; Objekti i Ri Komunës

Rr: "Ahmet Krasniqi" Arbëri – Prishtinë

## Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042, ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht seksionin III.1 të Informacionit për Tenderuesit, dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësive të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	NSH "L-Consulting"
Adresa e plotë:	Zllakuqan, Klinë, pa nr.
Përfaqësuar nga:	
Emri	Luigj Markaj
Pozita	Drejtor
Nënshkrimi	
Data	17.11.2018
Vula	

